

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN

PËR

MBLEDHJEN, PËRPUNIMIN, TRANSMETIMIN, RUAJTJEN, FSHIRJEN, MBROJTJEN DHE GARANTIMIN E TË DHËNAVE TË INFORMACIONIT TË PASAGJERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për mbledhjen, përpunimin, transmetimin, ruajtjen, fshirjen, mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”, ka për qëllim të qartësojë kompetencat e autoriteteve kompetente dhe të SIP-it.

Objektivat dhe rezultatet e synuara janë:

- Përputhshmëria me Direktivat e BE-së: Direktivën 2004/82 KE të Këshillit të Europian të datës 29 prill 2004, mbi detyrimin e transmetimit të të dhënave të pasagjerit. Numri CELEX 32004L0082, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 261, datë 6.8.2004, faqe 24–27;
- Direktivën BE 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit, datë 27.4.2016, mbi përdorimin e të dhënave të regjistrimit të emrit të pasagjerit (PNR) me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale veprave me qëllime terroriste dhe krimeve të rënda. Numri CELEX 32016L0681, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 119, datë 4.5.2016, faqe 132–149 si edhe me Rregulloren (EU 2016/679) për GDPR të BE-së dhe Direktivën (EU 2016/680).
- Përcaktimi i kompetencave të autoriteteve të përfshira në shkëmbimin e të dhënave API dhe PNR.
- Zbatimi i Prioriteteve të Ministrisë së Brendshme dhe të detyrave të Programit Vjetor të DPPSH për vitin 2024.

Efektet kanë të bëjnë me rrugëtimin e Shqipërisë në BE dhe me nisjen e negociatave për të arrirë një marrëveshje për transmetimin e të dhënave PNR me BE-në që aktualisht nuk merren nga NIP për fluturimet me vendet e BE-së.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Këshillit të Ministrave, për vitin 2024, për ministrinë e Brendshme, katërmujori i tretë, si dhe në Planin Kombëtar i Integritimit Evropian.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i projektligjit paraqet disa avantazhe, ndër të cilat përmendim:

- Garantimi i sigurisë juridike, duke plotësuar boshllëqet e lëna nga Ligji nr. 71/2016 “Për kontrollin Kufitar”, i ndryshuar;
- Parashikim i detajuar i elementeve, duke shmangur kështu numrin e madh të dispozitave referuese dhe të akteve nënligjore të dala në kuadër të rregullimit të funksionimit dhe organizimit të API dhe PNR.
- Garantimi i pavarësisë së API - PNR.
- Garantimi i sigurisë të të dhënave të pasagjerit, pasi këto të dhëna do të transmetohen, përpunohen dhe përdoren vetëm nga një autoritet që ky ligj do të përcaktojë si pikën e vetme e marrjes, grumbullimin, analizimin dhe përdorimit të të dhënave të pasagjerit.
- Përcaktimi i qartë i përgjegjësive të Sektorit të Inteligjencës së Pasagjerit.
- Përckatimi i autoriteteve kompetente që kontribuojnë në mbarëvajtjen e punës së Sektorit të Inteligjencës së Pasagjerit.
- Përckatimi i autoriteteve kompetente të cilat kanë të drejtë të kërkojnë, të konsultojnë, të marrin të dhënat e pasagjerit ose rezultatet e përpunimit të tyre, me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin e ndjekjen penale të veprave penale. Garantimi i efikasitetit të veprimeve hetimore gjyqësore dhe zgjidhjes së çështjeve hetimore lidhur me veprimtarinë kriminale e konflikteve civile.
- Saktësimi i kompetencave të Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave të pasagjerit.
- Konsolidimi i normave, që kanë për objekt të dhënat API dhe PNR.

Njësia e Informacionit të Pasagjerit (N.I.P), e krijuar me Urdhër Nr. 203 datë 13.04.2021, pika 2, të Ministrit të Brendshëm, për disa ndryshime në Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr 177 datë 13.03.2018, “Për miratimin e Strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, është e përbërë nga 14 punonjës policie.

Për realizimin e trajtimit të informacioneve të pasagjerit specialistët e N.I.P ndjekin procedurat për marrjen, grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacioneve për personat e dyshuar e të shënjestruar për aktivitete të paligjshme në zbatim të përcaktimeve ligjore që rregullojnë punën e N.I.P. Pasagjerët të cilët janë objekt i punës së N.I.P janë të shënjestruar bazuar në rregulla dhe profile si edhe në listat e personave të njohur nga strukturat policore dhe autoritetet kompetente pjesë e N.I.P.

Për të realizuar në mënyrë efikase detyrat specialistët e N.I.P duhet të disponojë të gjithë informacionin e nevojshëm për të dhënat API/PNR të pasagjerëve. Të dhënat e pasagjerëve gjenden në bazat e të dhënave të kompanive, të cilat i përdorin për arsyet e tyre tregtare. Këto të dhëna përfaqësojnë një burim të madh informacioni policor, i cili me përpunimin e duhur kthehet në inteligjencë.

Specialistët e N.I.P regjistrojnë (automatikisht) në bazën e të dhënave të pasagjerit, të paktën veprimet e mëposhtme të përpunimit të të dhënave, që kanë të bëjnë me:

a) grumbullimin; b) ndryshimin; c) konsultimin; ç) shpërndarjen/transferimin (kombëtar dhe ndërkombëtar); d) depersonalizimin/anonimizimin; dh) fshirjen

Për të realizuar këto procedura pune, NIP ka nevojë për personel 24/7, për të mbajtur nën kontroll të gjithë lëvizjet e pasagjerëve dhe për të siguruar të gjitha të dhënat nga kompanitë në mënyrë të vazhdueshme, fluide, cilësore dhe të sakta.

Për kryerjen e këtyre proceseve, ka nevojë gjithashtu edhe për specialistë të analizës, të cilët krijojnë rregulla dhe profile bazuar në informacion policor, inteligjent dhe nga cdo burim i hapur apo i mbyllur të strukturave policore apo të autoriteteve kompetente.

Autoritetet kompetente sipas ligjit 71/2016, të ndryshuar, janë:

- a) Strukturat operacionale të Policisë së Shtetit;
- b) Shërbimi Informativ i Shtetit;
- c) Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

- c) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Autoritet kompetente caktojnë përfaqësues të tyre pranë NIP-it. Autoritetet kompetente përpunojnë të dhënat e pasagjerit, me qëllim përmirësimin e kontrollit kufitar, parandalimin e migracionit të paligjshëm, si dhe parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale, të krimeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 19/3, të ligjit 22/2022, dhe sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e përpunimit të të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit sanksionuar me VKM nr. 954 datë 02.12.2020 “Për përpunimin e të dhënave të pasagjerit”. Autoritetet kompetente mund të përdorin rezultatet e përpunimit të të dhënave të pasagjerit vetëm nëse vlerësojnë që përdorimi i tyre shërben për parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen penale të veprave të tjera penale.

NIP në këtë periudhë kohore të vënies në operativitet ka konstatuar, se ka disa probleme që lidhen me përditshmërinë e punës së saj që ndijon në krijimin e një produkti final gjithëpërfshirës për t’ia vënë në dispozicion autoriteteve kompetente.

Problematikat kanë të bëjnë kryesisht me:

1. Ligji aktual nr. 71/2016 “Për kontrollin Kufitar”, i ndryshuar parashikon vetëm transportuesit ajrorë duke e kufizuar fushën e veprimit të NIP, vetëm në përpunimin e të dhënave të pasagjerëve ajrorë
2. Mungesa e përpunimit të të dhënave të pjesës tjetër të pasagjerëve që udhëton nëpërmjet detit, aktualisht krijon një boshllëk ligjor që kërkon të mbushet sa më parë. Aktualisht, transportuesit detarë grumbullojnë të dhënat e pasagjerëve dhe i regjistrojnë ato rregullisht duke përbërë kështu një premisë të mirë për t’u përfshirë në ligjin e ri për të dhënat API/PNR.
3. Ligji aktual nr. 71/2016 “Për kontrollin Kufitar”, i ndryshuar përcakton formën e strukturës si “Njësi” e cila bie ndesh me ligjin për Policinë e Shtetit ku përcaktohen format e strukturave të Policisë së Shtetit dhe në nivel qendror Njësia përfaqëson një strukturë më të vogël dhe me grada jo të përshtatshme për NIP. Projektligji përcakton formën e strukturës si Njësi e thjeshtë si dhe do të parashikojë Sektorin e Inteligjencës së Pasagjerit për t’i dhënë nivelit të përfaqësimit të saj më tej me rregulloren e saj rëndësinë e duhur. Ajo do të përcaktohet si sektor i vecantë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Departamentin e Policisë Kriminale.
4. Gjithashtu, ligji aktual nr. 71/2016 “Për kontrollin Kufitar”, i ndryshuar, nuk ka qartësuar kompetencat e autoriteteve kufitare dhe të NIP-it duke sjellë shpesh në keqinterpretim të tij. SIP nuk është pjesë e autoriteteve kufitare, por strukturë e vecantë inteligjente.

5. Në Ligjin aktual nr. 71/2016 “Për kontrollin Kufitar”, i ndryshuar, nuk parashikohet mënyra e transmetimit të të dhënave nga transportuesit ajrorë në NIP. Aktualisht kjo bëhet nëpërmjet një operatori ekonomik, i cili paguhet nga SHBA, por që do të jetë vetëm për një periudhë 3-5 vite nga funksionimi i NIP, në zbatim të ligjit nr. 121/2020 “Për ratifikimin e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me Bashkëpunimin për përdorimin e Informacioneve për Udhëtarët” .

- Në projektligj do të përcaktohen qartë cilat janë të dhënat e pasagjerit duke specifikuar, të dhënat paraprake (API) dhe ato të regjistrimit të emrit të pasagjerit (PNR), si edhe do të shtohet që specialistët e S.I.P regjistrojnë edhe manualisht edhe automatikisht në bazën e të dhënave të pasagjerit, të paktën veprimet e mëposhtme të përpunimit të të dhënave, që kanë të bëjnë me:

a) mbledhjen; b) përpunimin; c) transmetimin; ç) shkëmbimin për përdorimin kombëtar dhe ndërkombëtar; d) ruajtjen; dh) fshirjen/ shkatërrimin; e) pseudonimizimin dhe/ose anonimizimin e të dhënave; ë) mbrojtjen dhe garantimin e të dhënave.

Në projektligj janë parashikuar edhe autoritete të tjera përveç atyre aktuale bazuar në kërkesat e institucioneve përkatëse si prokuroritë apo gjykatat, përfshirë edhe ato të posacme.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i paraqitur për miratim është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj synon përafrimin të pjesshëm me acquis të Bashkimit Evropian, konkretisht me:

Direktivën 2004/82 KE të Këshillit të Europian të datës 29 prill 2004, mbi detyrimin e transmetimit të të dhënave të pasagjerit. Numri CELEX 32004L0082, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 261, datë 6.8.2004, faqe 24–27;

- Direktivën BE 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit, datë 27.4.2016, mbi përdorimin e të dhënave të regjistrimit të emrit të pasagjerit (PNR) me qëllim

parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale veprave me qëllime terroriste dhe krimeve të rënda. Numri CELEX 32016L0681, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 119, datë 4.5.2016, faqe 132–149 si edhe me Rregulloren (EU 2016/679) për GDPR të BE-së dhe Direktivën (EU 2016/680)..

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për marrjen, grumbullimin, analizimin dhe përdorimin e të dhënave të informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë”, **përmban 18 (tetëmbëdhjetë) nene.**

Në nenin 1, përcaktohet qëllimi i projektligjit. .

Në nenin 2, janë përcaktuar përkufizime të ndryshme, të lidhura me përmbajtjen e projektaktit.

Në nenin 3, parashikohet Sektori i Inteligjencës së Pasagjerit dhe baza e të dhënave të pasagjerit dhe kompetencat e tij.

Në nenin 4, parashikohet mënyra e transmetimit të të dhënave të pasagjerit.

Në nenin 5, parashikohet përpunimi i të dhënave të pasagjerit.

Në nenin 6, parashikohet afati për transmetimin e të dhënave të pasagjerit.

Në nenin 7, përcaktohen autoritetet kompetente që kontribuojnë në mbarëvajtjen e punës së SIP.

Në nenin 8, përcaktohen autoritetet kompetente operative, të cilat kanë të drejtë të kërkojnë, të konsultojnë, të marrin të dhënat e pasagjerit ose rezultatet e përpunimit të tyre, me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin e ndjekjen penale të veprave penale.

Në nenin 9, përcaktohet mënyra e transferimit ndërkombëtar të të dhënave.

Në nenin 10, përcaktohen kompetencat e Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave të pasagjerit.

Në nenin 11, përcaktohet procedura e për ruajtjen e të dhënave.

Në nenin 12, përcaktohet mënyra e ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave.

Në nenin 13, përcaktohen të drejtat e subjektit të të dhënave.

Në nenin 14, përcaktohet procedura për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale.

Në nenin 15, përcaktohen sanksionet.

Në nenin 16, përcaktohet e drejta e ankimit.

Në nenin 17, përcaktohet nxjerrja e akteve nënligjore.

Në nenin 18, përcaktohet akti që shfuqizohet.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet për zbatimin e këtij projektakti, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe Autoritetet Kompetente të përcaktuara në projektligj.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Brendshme dhe do të dërgohet për mendim tek: Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimit Informativ të Shtetit, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efekti financiar për hartimin dhe miratimin e ligjit do të jetë kosto administrative, pagat e punonjësve që do të marrin pjesë sipas urdhrave për ngitjen e grupeve të punës.

Kjo shumë duke qenë se nuk është e konsiderueshme, do të përballohet nga programi buxhetor “Për Policinë e Shtetit” të miratuar për periudhat përkatëse.

Sqarojmë gjithashtu se kostoja financiare lidhet drejtpërsëdrejti me pagesat që do të duhet të bëhen për operatorin ekonomik për transformimin e të dhënave të pasagjerit. Kostoja aktuale që mbulohet nga Qeveria e SHBA është rreth 150 000 Dollar në vit. Kostoja e përafërt e pagesës së Operatorit ekonomik duke konsideruar rritjen e numrit të pasagjerëve dhe rritjen e numrit të aeroporteve të Shqipërisë është rreth 200 000 Dollar në vit. Këto kosto janë të justifikuara me rritjen e kapaciteteve të parandalimit të krimeve të rënda dhe të terrorizmit që Sektori i Inteligjencës së Pasagjerit ka arritur në këto dy vite të punës së plotë.

Kostoja e përafërt për operatorin ekonomik nuk i kalon 200 000 (dyqind mijë) dollarë në vit nëse ne marrim për bazë koston aktuale ndërkohë që me shtimin e flukseve të pasagjerëve dhe aeroporteve përfshirë edhe kompanitë detare kostoja nuk i kalon 250 000 (dyqind e pesëdhjetë) mijë dollarë në vit.

Me datë 08.05.2020, është nënshkruar “Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me bashkëpunimin për përdorimin e informacioneve për udhëtarët”, ratifikuar me ligjin nr. 121/2020.

Nëpërmjet këtij memorandumi bashkëpunimi, palët, duke u mbështetur mbi mekanizmat aktualë të suksesshëm për përdorimin e informacionit mbi udhëtarin për të identifikuar rreziqe të mundshme ndaj sigurisë, kanë si qëllim ngritjen e një kuadri për bashkëpunim në vlerësimin dhe shqyrtimin e informacionit mbi udhëtarin. Qëllimi i këtij memorandumi bashkëpunimi është të garantojë siguri dhe të mbrojë jetën dhe sigurinë e publikut. Për këtë arsye, Palët do të punojnë për të parandaluar, zbuluar, hetuar dhe ndjekur penalisht terrorizmin dhe krimin me karakter ndërkombëtar.

Deri në vitin 2025, pagesa e operatorit ekonomik do të mbulohet nga SHBA.

Pas shtatorit të vitit 2025, kjo shumë, do të përballohet nga programi buxhetor “Për Policinë e Shtetit”.

PROPOZUESI

MINISTRI I BRENDSHËM

ERVIN HOXHA

Konceptoi: G. Akshia

Pranoi: A. Toma

Miratoi: E. Lala

M. Cuka

Konfirmoi: S. Hoxha